



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I.-21-0042-A0001

Në çështjen juridike të:

D K Kaçanik.

Paditësi/ankuesi

Kundër:

Agjencisë Kosovare të Privatizimit(AKP), Rr. "Agim Ramadani" nr. 23, Prishtinë.

E paditura

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Ilmi Bajrami gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr.sc Sahit Sylejmani gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit/ankuesit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-7011, të datës 21 dhjetor 2020, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 13 janar 2022, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. **Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
2. **Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-7011, i datës 21 dhjetor 2020.**
3. **Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 22 maj 2014 paditësi kishte parashtruar një ankesë në DHPGJSK kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH "Sharr", që administrohet nga AKP (AL i AKP-së) GJI042-4454 të datës 15 tetor 2014. Me këtë vendim AL i AKP-së e kishte refuzuar si të pavlefshme kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën kohore nga 18 tetor 1991 deri më 12 qershor 1999 në shumën prej 165.011,00 euro, pasi që kërkesa është parashtruar konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar(LPB). Ankuesi pretendon se ai nuk i ka

realizuar të ardhurat personale, edhe pse disa herë i është drejtuar organeve kompetente të ndërmarrjes për realizimin e tyre. Ankuesi konsideron se në këtë rast kemi të bëjmë me një diskriminim direkt, edhe pse ka qenë i diskriminuar edhe nga ana e organeve të mëparshme nga ish-sistemi. Sipas tij, pos premtimeve se kërkesa e tij do të shqyrtohet në mënyrë pozitive, ai nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me këtë kërkesë

Në përgjigjen e saj të datës 12 tetor 2020 AKP ka pohua se e ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka aplikuar dispozita ligjore në mënyrë të drejtë. Sipas AKP-së, kërkesa e paditësit është e parashkruar, sepse nuk ka dëshmi që kjo kërkesë të jetë parashtruar para një gjykate apo organi tjetër kompetent brenda tri vitesh nga dita kur pretendohet të ketë lindur detyrimi. AKP propozon që ankesa të refuzohet e të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Më 21 dhjetor 2020 Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykimin C-IV.-14-7011 me të cilin ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pa bazuar dhe e kishte vërtetuar vendimin e ankimuar të AL të AKP-së, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Shkalla e parë kishte konstatuar se kjo kërkesë ishte parashkruar konform nenit 372 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve(LMD) i vitit 1978 që është ligj i aplikueshëm për këtë periudhë për të cilën kërkohet kompensimi. Me këtë dispozitë ligjore parashihet që kërkesat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda 3 vitesh nga dita kur ka lindur detyrimi. Të njëjtën zgjidhje e ka mbajtur edhe LMD i ri, që është aktualisht në fuqi. Kjo kërkesë e ka arritur parashkrimin në fund të vitit 2003, ndërsa për herë të parë ankuesi e ka parashtruar kërkesën për herë të parë para AL të AKP-së në vitin 2011. Paditësi me rastin e parashtrimit të kërkesës tek AL i AKP-së nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të mundësonte ndryshimin e rrethanave faktike sa i përket parashkrimit të të drejtës së pretenduar. Po ashtu, paditësi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar se ai ka parashtruar këtë kërkesë në ndonjë gjykatë, apo organ tjetër kompetent, që do të dëshmohej ndërprerja e rrjedhës së parashkrimit.

Më 31 tetor 2019 paditësi kishte parashtruar ankesë ndaj këtij aktgjykimi për shkak të të gjitha bazave ankimore. Ankuesi thekson se me aktgjykimin e ankimuar janë shkelur dispozitat e procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 2 lidhur me nenin 399 të LPK-së, sepse atij nuk i është dhënë mundësia që para gjykatës të deklarohet lidhur me pretendimet e AKP-së. Ankuesi e kundërshton edhe vlerësimin gjyqësor se kërkesa është parashkruar konform nenit 608 të LPB-së, sepse sipas tij, ai nuk ishte ligj në aplikim, sepse ishte shfuqizuar. Ankuesi

thekson se ai ishte larguar nga puna në vitin 1990 bazuar në vendimin e masave të dhunshme të instaluar në këtë NSH nga pushteti serb dhe ky fakt vërtetohet edhe me Vërtetimin e datës 13 korrik 2006 të lëshuar nga NSH e paditur.

Ankuesi pohon se nuk ka mundur të parashtrijë kërkesën për realizimin e të drejtës së tij në gjykatë, sepse puna e Gjykatës Komunale të Kaçanikut gjatë kësaj periudhe u suprimua dhe kaloi në kompetencë të Gjykatës Komunale në Ferizaj, andaj ky fakt nuk është marrë parasysh dhe me këtë rast është bërë shkelje e dispozitave të procedurës kontestimore, sepse arsyetimi i aktgjykimit për faktet vendimtare është në kundërshtim me vetveten. Ankuesi mendon se aplikimi i LMD-së nga viti 1978 nuk është i mundur, sepse, sipas tij, me Ligjin për Marrëdhënie të Punës të KSAK të datës 14 prill 1989 dhe me Ligjin për të Drejtat nga Marrëdhënia e Punës e datës 28 shtator 1989, nuk parashihet parashkrimi i kërkesave nga marrëdhënia e punës, e që ka qenë në fuqi edhe pas vitit 1999. Ankuesi propozon që ta anulohet aktgjykimi dhe çështjen ta kthejë në rigjykim.

Më 06 dhjetor 2021 Kolegji i Apelit këtë ankesë e ka dërguar për përgjigje tek AKP. Në përgjigjen e saj të datës 10 dhjetor 2021, ndaj ankesës së paditësit, AKP i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të paditëses si të pa bazuara dhe propozon që si e tillë ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj. AKP pohon se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë valide juridikisht të besueshme se ai ka parashtruar kërkesën e tij para një gjykate apo organi kompetente brenda 3 vitesh.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Shkalla e parë e DHPGJSK-së, me aktgjykimin e ankimit, ankesën e paditëses e kishte refuzuar si të pa bazuar, me arsyetimin se kërkesa ishte parashkruar

Ankuesi e kundërshton vlerësimin gjyqësor se kërkesa është parashkruar konform nenit 608 të LPB-së, sepse sipas tij, ai nuk ishte ligj në aplikim, pasi që ishte shfuqizuar. Ankuesi pohon se nuk ka mundur të bëjë kërkesë në gjykatë për të drejtat e tij sepse puna e Gjykatës Komunale

të Kaçanikut gjatë kësaj periudhe u suprimua dhe kaloi në kompetencë të Gjykatës Komunale në Ferizaj, andaj ky fakt nuk është marrë parasysh dhe me këtë rast është bërë shkelje e dispozitave të procedurës kontestimore, sepse arsyetimi i aktgjykimit për faktet vendimtare është në kundërshtim me vetveten.

Kolegji i Apelit pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore të paditësit, aktgjykimin e ankimuar dhe provat e parashtruara, erdhi në përfundim se ankesa është e pa bazuar.

Ankuesi e kundërshtoi aplikimin e nenit 608 të LPB-së nga gjykata, sepse konsideron se ai nuk ishte ligj në fuqi. Kolegji i Apelit ka gjetur se ky pretendim ankimor nuk është i bazuar, sepse Shkalla e parë nuk e ka aplikuar këtë dispozitë, përkundrazi, është sqaruar në mënyrë të detajuar se si dhe kur ishte shfuqizuar. Për këtë arsye Shkalla e parë ka konstatuar se në këtë rast specifik duhet të merret për bazë parashkrimi i përgjithshëm për detyrime civile lidhur me kërkesat periodike dhe këto rregulla gjenden në LMD e viti 1978 në nenin 372, paragrafi 1. Me këtë konstatim të Shkallës së parë pajtohet në tërësi edhe Kolegji i Apelit, sepse kërkesa në secilin variant të pretenduar nga paditësi, është parashkruar.

Paditësi është i vetëdijshëm se ka paarshtuar kërkesën jasht afatit ligjor, por ai kërkon kthim në gjendje të më parshme në mënyrë që të filloj procedurat në realizimin e të drejtës së tij të pretenduar. Propozimi për kthim në gjendje të më parshme mund të bëhet brenda afatit prej 7 ditësh nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, apo nga dita kur pala ka mësuar për mosveprimin, konform nenit 130 paragrafi 2 i LPK-së.

Paditësi gjithashtu e pranon faktin se kërkesa është parashtruar jashtë afatit që determinon parashkrimin e kërkesës, por arsyetohet se ai nuk ka mundur ta parashtrroj këtë kërkesë në gjykatë, sepse puna e Gjykatës Komunale të Kaçanikut gjatë kësaj periudhe u suprimua dhe kaloi në kompetencë të Gjykatës Komunale në Ferizaj.

As ky argument nuk është i qëndrueshëm, sepse kërkesa ka mundur të parashtrohet në gjykatën kompetente, në këtë rast konkret në Gjykatën Komunale të Ferizajt, por paditësi ka dështuar ta bëjë një gjë të tillë dhe nuk ka arritur që ta ndërpres rrjedhën e afatit të parashkrimit.

Për këto arsye si më lartë, ankesa refuzohet si e pa bazuar dhe rrjedhimisht vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Pasi që tashmë paditësi/ankuesi ka paguar taksën gjyqësore në emër të ankesës së parashtruar, ai nuk ngarkohet me taksës shtesë gjyqësore.

Vendosur nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 13 janar 2022.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues _____

